



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

LETËR MBËSHTETËSE
POPULLIT
DHE
KOLEGËVE NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Sot na zgjoi një mëngjes me pikëllim dhe brengë për bashkëkombasit tonë në Republikën e Shqipërisë, me rastin e termetit i cili goditi territorin e vendit. Është tejet e dhimbshme të dëgjojmë lajmet e tillë, e aq më shumë për humbjet e jetave dhe pësimin e lëndimeve nga banorët e zonave të goditura.

Me këtë rast, shfrytëzojmë rastin që t'i ngushllojmë të gjitha familjet që kanë humbur të dashurit e tyre, ndërkaq të lënduarve iu urojmë shërim sa më të shpejt dhe të dëmturëve iu dëshirojmë rikuperim sa më të shpejt.

Shprehim gatishmërinë e plotë, që në emër të komunitetit mjekësor nga Republika e Kosovës dhe Odës së Mjekëve të Kosovës, të ofrojmë çfarëdo ndihme, qoftë ajo profesionale, materiale, fizike apo morale. Për këtë do të jemi në kontakt të vazhdueshëm me organizatën simotër, Urdhërin e Mjekëve të Shqipërisë.

Mbahuni të fortë dhe kujtoni se nuk jeni të vëtmuar. Ne na mbetet të kujtojmë atë që Ju keni bërë kur Kosova digjej, ndërsa populli shqiptar i Kosovës vritej, përdhunohej dhe përndiqej.

Me solidaritet,

Prishtinë, 26 nëntor 2019

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, mr.Sci

